

MBANI MEND

- TI JE PRONAR I TRUPIT TËND! TI VENDOSË!
- Mos ke turp! Na kontakto! Ne mund të të ndihmojmë!
- Edhe meshkujt mund të jenë viktima të dhunës seksuale!
- Përqendrohu te ruajtja e provave që do të shërbejnë për sjelljen e kryerësit para drejtësisë!

KOHA ËSHTË ARMIKU KRYESOR I PROVAVE BIOLOGJIKE

STATISTIKAT E INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE në lidhje me dhunën seksuale

- Shumica e viktimave të dhunës seksuale janë të moshës 11 deri 16 vjeçare.
- Në 81% të rasteve të dhunës seksuale, kryerësi i veprës është person i njohur për viktimën.
- Vetëm në 28% të rasteve të dhunës seksuale provat biologjike mund të mblidhen.
- Rreth 90% e viktimave të dhunës seksuale janë të gjinisë femërore.

Për të pasur qasje në këtë broshurë dhe për informata shtesë, vizitoni këto faqe të internetit:

www.mjekesialigjore-ks.com

www.eulex-kosovo.eu



INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

MA THUAJ
ME KOHË

DHUNA SEKSUALE
ËSHTË KRIM



Ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe mbështetet financiarisht nga EULEX-i.



SI TË SHMANGEN SITUATAT POTENCIALISHT TË RREZIKSHME

- Mos flisni me persona të panjohur.
- Mos hyni në vetura me persona të panjohur.
- Mos konsumoni alkool apo substanca narkotike kur dilni nëpër lokale apo kur jeni me shoqëri.
- Mos qarkulloni nëpër rrugë pa ndriçim gjatë natës.
- Kujdes me rrjetet sociale:
 - Mos pranoni kërkesa për miqësi nga njerëz që nuk i njihni;
 - Mos postoni foto të tërë trupit tuaj;
 - Mos pranoni ndihmë nga ata që nuk i njihni.

DHUNA SEKSUALE

është **vepër penale** që mund të ndodhë kudo rreth nesh dhe çdokush mund të jetë viktimë e një akti të tillë.

Elementi kryesor që e bën dallimin mes aktit seksual dhe dhunës seksuale është – **PËLQIMI**.

Ka shumë mite që ndërlidhen me këtë vepër penale, por e vërteta është se as veshja, as vendi, as mosha, e as lidhja e viktimës me dhunuesin nuk kanë fare të bëjnë me kryerjen e një akti të tillë. Shkaktari kryesor i dhunës seksuale, si dhe i formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, është **keqpërdorimi i forcës** (qoftë fizike ose psikike) **nga ana e dhunuesit**.

Rruga e viktimave deri te drejtësia nganjëherë është e gjatë dhe me shumë pengesa. Me këtë broshurë ne synojmë që të kalojmë së paku një nga ato pengesa!

NËSE JE VIKTIMË E DHUNËS SEKSUALE, RUAJI PROVAT BIOLOGJIKE NË KËTË MËNYRË:

- MOS U PASTRONI!
- MOS BËNI DUSH!
- MOS I PASTRONI DHËMBËT!
- MOS I NDËRRONI RROBAT!
- SHMANGNI USHQIMIN APO PIJEN!

RAPORTOJENI RASTIN SA MË SHPEJTË QË ËSHTË E MUNDUR NË STACIONIN MË TË AFËRT TË POLICISË APO NË NUMRIN E TELEFONIT 192

ÇKA JANË PROVAT BIOLOGJIKE?

Lëngjet trupore (pështyma, gjaku, sperma, qimet, qelizat epiteliale) që kryerësi i veprës apo viktimë lënë tek njëri-tjetri apo në vendin e ngjarjes njihen si **prova biologjike**.

PROVAT BIOLOGJIKE JANË ELEMENTE SHKENCORE KYÇE

që dëshmojnë përfshirjen e kryerësit në krim.



**NËSE JU NEVOJITET NDIHMË,
THIRRNI NUMRIN 192**